


## I. Mjedisi ndërkombëtar

Dobësimi i mëtejshëm i ekonomisë amerikane, europiane dhe asaj japoneze bëri që situata ekonomike botërore, gjatë tremujorit të dytë të vitit 2001 të paraqitej e brishtë. Treguesit makroekonomikë të pjesës së parë të vitit 2001 për secilën nga ekonomitë e lartpërmendura bënë që parashikimet për rritjen e ekonomisë botërore për këtë vit të uleshin nga 4.2 për qind në 3.2 për qind (në muajin maj) dhe më pas në 2.6 për qind (në muajin shtator)<sup>1</sup>. Aktet terroriste të datës 11 shtator 2001, do të kenë ndikime shtesë në ekonominë amerikane dhe në krejt ekonominë botërore. Përballë zhvillimeve të fundit Rezerva Federale e pa të arsyeshëm vazhdimin e politikës ekspansioniste që ka ndjekur që prej fillimit të vitit 2001. Që prej muajit janar ajo i ka ulur normat e interesit nëntë herë duke i çuar ato nga niveli 6.5 për qind në nivelin 2.5 për qind. Dy prej këtyre uljeve, secila me nga 0.5 pikë përqindjeje, janë bërë pas ngjarjeve të 11 shtatorit 2001. E njëjta politikë, ndonëse në masë më të reduktuar, është ndjekur edhe nga Banka Qendrore Europiane e cila i ka çuar normat e interesit në nivelin 3.75 për qind nga 4.75 për qind në fillim të vitit.

Grafiku 1: Parashikimi për rritjen e PBB-së për vitin 2001 në muajt maj dhe shtator 2001\* (në %).



Shënim: \*Parashikimi i muajit shtator nuk merr parasysh ngjarjet e datës 11 shtator në SHBA.

***Ekonomia amerikane*** u rrit me 0.3 për qind gjatë tremujorit të dytë të këtij viti duke shënuar në këtë mënyrë një rritje më të ulët se ajo e tremujorit të parë (1.3 për qind) dhe shumë më të ulët nga ajo e të njëjtit tremujor për vitin paraardhës (5.7 për qind). Prodhimi industrial ra me 5.9 për qind gjatë tremujorit të dytë pas një rënieje prej 7.9 për qind në tremujorin e parë të vitit 2001. Faktori që ka ndikuar më fuqimisht në ngadalësimin e rritjes së PBB-së është pakësimi i investimit të bizneseve në pajisje. Ky tregues gjatë këtij tremujori ka rënë me një ritëm vjetor prej 13.6 për qind duke e ulur rritjen totale të PBB-së me 1.5 pikë përqindjeje.

<sup>1</sup> Të dhënat janë marrë nga FMN, World Economic Outlook, Shtator 2001.

Në mes të një papunësie në rritje (4.5 për qind) tregu i punës po provon në të njëjtën kohë, rritjen e pagave dhe të kompensimeve. Rritja vjetore prej 3.7 për qind e pagave duke qenë më e lartë se rritja prej 3.4 për qind në çmimet e konsumit, u ka mundësuar konsumatorëve të vazhdojnë të shpenzojnë dhe të kursejnë në nivele disi më të larta nga ato që parashikoheshin. Sektori i teknologjisë së informacionit është ai që vazhdon të përbëjë problemin kryesor në ekonominë amerikane. Kompanitë e *software*-it vazhdojnë të shesin stoqet e grumbulluara gjatë tre viteve të fundit, duke ulur gjatë kësaj kohe shpenzimet në pajisjet e përpunimit të informacionit.

Prej fillimit të vitit deri në fund të muajit qershor Rezerva Federale, me qëllim që t'i jepte një shtytje ekonomisë amerikane nëpërmjet rritjes së shpenzimeve të konsumit, uli interesat afatshkurtër shtatë herë duke i çuar ata në nivelin 3.5 për qind.

**Japonia** mbetet pika më e dobët e ekonomisë botërore pavarësisht nga ulja e interesave afatshkurtër deri në nivelin zero për qind. Eksportet që përbëjnë një nga shtyllat më të fuqishme të kësaj ekonomie, kanë vazhduar të pësojnë rënie duke bërë në këtë mënyrë që prodhimi industrial të bjerë me 3.7 për qind në pjesën e parë të vitit 2001.

**Ekonomia europiane.** Rritja e PBB-së reale në zonën e euros gjatë vitit 2001, pritet të bjerë nga nivelet e larta të arritura në vitin 2000. Sipas parashikimeve të jashtme, kjo rritje në vitin 2001 do të jetë 2.5 për qind nga 3.4 për qind që ka qenë ritmi i rritjes në vitin 2000, ndërkohë që parashikimet e vetë zonës konkludojnë se rritja e PBB-së për vitin 2001 do të jetë midis vlerave 2.2 dhe 2.8 për qind. Dobësimi i rritjes në zonën e euros ka qenë më i madh nga ç'pritej disa muaj më parë. Sidoqoftë, duke pasur parasysh vlerësimet që janë bërë për rritjen potenciale të kësaj zone, mund të thuhet se ecuria ekonomike e zonës së euros nuk përbën burim shqetësimi dhe pesimizmi.

Treguesi i besimit të biznesit ka vazhduar të bjerë gjatë muajve të fundit duke pasqyruar një kërkesë botërore në ulje. Nga ana tjetër, treguesi i besimit të konsumatorëve ka vazhduar të qëndrojë në nivele të larta. Rritja e vazhdueshme në punësim dhe ulja e taksave direkte, bëjnë që pritshmëria për konsumin privat të mbetet në nivele të larta.<sup>2</sup>

Banka Qendrore Europiane, gjatë tremujorit të dytë të vitit 2001, është treguar tepër e kujdesshme në politikën që ka ndjekur lidhur me normat e interesit të operacioneve refinancuese të Eurosistemit. Ulja e shumëpritur e muajit maj (me ¼ pikë) i çoi këto norma në nivelin 4.5 për qind. Një ulje e së njëjtës masë u bë edhe me normat e kredihënies dhe depozitave të cilat kapën respektivisht nivelet 5.5 dhe 3.5 për qind. Kjo lëvizje e Bankës Qendrore Europiane erdhi kryesisht si pasojë e zhvillimeve negative që u vunë re në ekonominë gjermane<sup>3</sup>.

<sup>2</sup> Burimi: European Central Bank, Monthly Buletin, April 2001.

<sup>3</sup> Burimi: Business Week, 30 July, 2001, "Lots of gloom and no relief", pg 11.

Banka Qendrore Europiane e ka justifikuar politikën e saj të matur me objektivin e ruajtjes së stabilitetit të çmimeve në terma afatmesëm. Drejtuesit e bankës janë shprehur se nxitja e rritjes ekonomike të rajonit nuk bënte pjesë në listën aktuale të objektivave të bankës. Inflacioni për zonën e euros, në fund të muajit qershor, ishte rreth 3 për qind, kurse në korrik rezultoi 2.8 për qind. Sipas parashikimeve, ky tregues do të zbresë në nivelin 2 për qind deri në fund të këtij viti si pasojë e zhdukjes së efekteve të faktorëve të sipërpërmendur, të ngritjeve të kaluara në çmimin e naftës apo të zhvlerësimit që pësoi euro gjatë vitit 2000.

**Ekonomia e rajonit.** Në analizën e ekonomisë së rajonit mendojmë se është me vend të ndalemi në zhvillimet e fundit ekonomike dhe financiare në Maqedoni dhe në Turqi.

Kriza politike në **Maqedoni** ka bërë që prodhimi i vendit të paralizohet përkohësisht. Ndërkohë që ndikimi më i drejtpërdrejtë i krizës maqedonase në Shqipëri ishte ndërprerja, pothuajse e plotë, e importeve nga Maqedonia. Boshllëku i krijuar nga mungesa e importeve, sidomos i frutave dhe perimeve, për në Shqipëri u pasqyrua në një rritje të çmimeve të këtyre produkteve në tregun shqiptar që ndikoi në rritjen e nivelit të inflacionit.

**Turqia** nisi të ndjente trokitjet e krizës ekonomike dhe financiare në fund të vitit të kaluar kur një numër bankash u ballafaquan me probleme likuiditeti. Kriza financiare, që shpërtheu në muajin shkurt të këtij viti e acaroi gjendjen e cila rezultoi në një zhvlerësim masiv (pothuajse 100 për qind) të monedhës vendase dhe rritje të menjëhershme të papunësisë. Gjatë tremujorit të dytë, PBB-ja e vendit ra me 9.3 për qind në krahasim me tremujorin e dytë të vitit të kaluar.

Një nga problemet më të mëdha për Turqinë sot mbetet financimi i borxhit publik, stoku i të cilit ka arritur në nivelin 70 për qind të PBB-së. Programi i ri, i ndërmarrë nga qeveria, e vë theksin mbi masat legjislative në sektorin bankar, shpejtimin e privatizimit dhe shtrëngimin fiskal. Këto masa, të kombinuara me financimin e jashtëm pritet që të ndalojnë rënien ekonomike dhe të ulin nivelin e inflacionit. Sipas parashikimeve optimiste, Turqia do të realizojë një rritje negative prej 3 për qind dhe do të arrijë një nivel inflacioni prej 52.5 për qind gjatë vitit 2001.

Zhvillimet e fundit në Shtetet e Bashkuara<sup>4</sup>, mund të rrisin nivelin e rrezikut që investitorët perceptojnë për rajonin. Vështirësitë që po kalojnë momentalisht Shtetet e Bashkuara supozohet të kenë ndikimin e tyre mbi ecurinë e borxhit të jashtëm të Turqisë, e cila planifikonte të siguronte dy miliardë dollarë deri në fund të këtij viti.

Situata në Turqi nuk vlerësohet të ketë ndikim të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershëm mbi ekonominë shqiptare. Megjithatë, Banka e Shqipërisë gjykon

---

<sup>4</sup> Burimi: "First impression: after the attack", 12 September 2001, Steven R. Philipp, RZB Austria-London Branch.

se krizat e vazhdueshme në vendet e rajonit po e mbajnë të lartë rrezikun e tij për investitorët. Ky nivel rreziku ka të ngjarë të dëmtojë thithjen e investimeve për periudha afatmesme si edhe të krijojë probleme për procesin e privatizimit.

## **II. Zhvillimet në ekonominë e brendshme**

### **II.1. Konsiderata të përgjithshme.**

Në tremujorin e dytë të vitit ekonomia shqiptare vazhdon në po ato tendenca të vërejtura gjatë tremujorëve paraardhës. Megjithatë, mbajtja e zgjedhjeve parlamentare ndikoi në zhvillimet e këtij tremujori. Në tërësi, përforcohet tendenca e një sektori shtetëror në turrje dhe e një sektori privat në gjallërim (i cili gjykohet ende nga tregues të tërthortë). Është e qartë që dinamika e sektorit privat ndikon në dinamikën e krejt ekonomisë. Përsa i përket zhvillimeve sipas sektorëve të ekonomisë vërehet që jo të gjithë sektorët premtajnë zhvillime optimiste. Ndërkohë që janë rritur aktiviteti industrial, investimet publike, sidomos ato në infrastrukturë apo është gjallëruar sektori i transportit, bujqësia dhe ndërtimi paraqiten më pak optimistë. Prodhimi bujqësor pritet të mos realizohet në masën e parashikuar, ndërsa dega e ndërtimit të reduktojë disi ritmet e rritjes së saj. **Duke patur parasysh që bujqësia përfaqëson gati gjysmën e PBB-së, ndërtimi degën më dinamike gjatë dekadës së kaluar, si edhe problemet që do të vijojnë me energjinë elektrike, vlerësohet se është vështirësuar arritja e objektivit për rritjen e PBB-së dhe kjo do të varet ndjeshëm nga ecuria në tremujorët pasardhës.**

### **II. 2. Bujqësia.**

Për vitin 2001 pritet që në total të realizohet 220.3 milionë lekë prodhim (me çmimet e vitit 2000) ose një rritje prej 3.6 për qind krahasuar me prodhimin e realizuar një vit më parë. Rreth 90.4 për qind e këtij prodhimi parashikohet të realizohet nga prodhimet bujqësore e blegtorale. Realizimi i këtij parashikimi do të mbështesë edhe realizimin e rritjes ekonomike në kufirin e programuar prej 7.3 për qind në vitin 2001.

Tabela 1: Parashikimi i pritshëm i prodhimeve bujqësore e blegtorale (me çmimet e vitit 2000).

Emërtimi	Prodhimi i vitit 2000		Parashikimi i vitit 2001		Në %
	000/ton	Mln lekë	000/ton	Mln lekë	
<b>Bimët e arave</b>		<b>87315</b>		<b>86313</b>	<b>98.9</b>
1. Grurë	341.0	10230	300.0	9000	
2. Misër	205.7	6377	220.0	6820	
3. Perime	620.0	45260	620.0	45260	
4. Patate	161.0	6440	160.0	6400	
5. Fasule	25.2	3503	22.0	3058	
6. Duhan	6.2	2418	6.5	2535	
7. Lule dielli	2.9	203	2.7	189	
8. Panxharsheqeri	42.0	252	40.0	240	
9. Sojë	0.6	90	0.6	90	
10. Foragjere	4 730.0	11825	4 800.0	12000	
11. Elb	3.3	231	3.3	231	
12. Tagjira	15.7	487	15.8	490	
<b>Pemëtaria</b>		<b>15916</b>		<b>18406</b>	<b>115.6</b>
1. Pemë frutore	64.9	5062	75.0	5850	
2. Ullinj	36.2	2353	37.0	2405	
3. Agrume	2.6	164	2.8	176	
4. Rrush gjithsej	79.4	8337	95.0	9975	
<b>Blegtoria</b>		<b>89746</b>		<b>94408</b>	<b>105.2</b>
1. Qumësht	948.0	38868	990.0	40590	
2. Vezë (mln kokrra)	530.0	4240	590.0	4720	
3. Lesh	3.4	333	3.4	333	
4. Mjaltë (ton)	1.1	385	1.1	385	
5. Mish-peshë e gjallë	112.0	45920	118.0	48380	
<b>Totali</b>		<b>192 977</b>		<b>199 127</b>	<b>103.2</b>

Burimi: Zyra përfaqësuese e FMN në Tiranë.

Tabela 2: Parashikimi i prodhimit bujqësor i vlerësuar për vitin 2001 (në milionë lekë).

Emërtimi	Viti 2000	Parashikimi 2001	Në %
1. Bujqësia	192 977	199 127	103.2
2. Agroindustria	17 946	19 200	107.0
3. Peshkimi	1 668	1 750	104.9
<b>Totali</b>	<b>212 591</b>	<b>220 277</b>	<b>103.6</b>

Burimi: Zyra përfaqësuese e FMN në Tiranë.

Nisur nga disa të dhëna operative<sup>5</sup> të mbjelljeve të pranverës, duket se në prodhimin bujqësor, të paktën sivjet, është bërë një hap prapa në mbjellje. Kështu, është mbjellë rreth 10 për qind më pak misër e perime në fushë, 27 për qind më pak fasule, 29 për qind më pak luledielli etj.. Pra, janë mbjellë, pothuajse në të gjitha kulturat bujqësore, sipërfaqe më të vogla krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2000.

Përqindjet e konsiderueshme të zvogëlimit të sipërfaqes së mbjellë pritet të sjellin uljen e prodhimit të kulturave bujqësore në periudhat në vazhdim. Kështu, pritet që prodhimi i grurit të jetë rreth 90 për qind e prodhimit real të të njëjtit produkt të

<sup>5</sup> Burimi i të dhënave për bujqësinë: Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit.

vitit të kaluar, ai i fasules të jetë rreth 70 për qind etj.. Ndërkohë, pritet të rritet në masë të vogël prodhimi i qumështit, i mishit e vezëve.

Prodhimi agroindustrial, gjatë këtij gjashtëmujori ka patur luhatje në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Rënie kanë pësuar kryesisht artikujt pije freskuese, miell, raki, ujë i gazuar etj.. Konstatohen rritje të prodhimit agroindustrial për artikujt vaj ulliri e luledielli, birra, ujë natyral, duhan i fermentuar, konserva peshku etj..

Në përkrahjen e zhvillimit të sektorit bujqësor, gjatë gjashtëmujorit të parë, kanë ndikuar investimet e kryera në këtë degë, të cilat kanë qenë kryesisht përfundime të projekteve të nisura. Rreth 60 për qind e investimeve totale të kryera gjatë peridhës gjashtëmujore janë përqëndruar në rehabilitimin dhe përmirësimin e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, gjë që mbetet përparësi në zhvillimin e bujqësisë.

Megjithatë, vlerësohet se aktualisht bujqësia mbetet akoma prapa për shkak të mangësive të infrastrukturës rurale, të strategjive për mbështetjen me kredi të prodhuesve dhe përpunuesve të prodhimeve bujqësore nga burimet e vendit, të shkallës së mekanizimit, të rehabilitimit e përmirësimit të infrastrukturës së ujitjes, të copëzimit të tokës dhe tregut të pazhvilluar të shitblerjes.

## **II. 3. Industria**

### **II. 3. 1. Sektori shtetëror.**

Në tremujorin e dytë të vitit 2001, prodhimi mall i shitur regjistroi shifrën e 4.8 miliardë lekëve<sup>6</sup> ose afro 26 për qind më lart se tremujori paraardhës.

Në këtë rritje ndikim pozitiv kanë dhënë shoqëritë aksionere Albpetrol, Armo, K.E.Sh. dhe Servcom. Në tremujorin e dytë, këto njësi të rëndësishme ekonomike, jo vetëm kanë realizime më të larta se një tremujor më parë, por njëherësh kanë manifestuar tejkalime të niveleve të parashikuara, përkatësisht me: 22.6, 11.6, 39.5 dhe 2.5 për qind. Vetëm K.E.Sh., ka kontribuar në masën 33.3 për qind në totalin e prodhimit mall të shitur për tremujorin e dytë të vitit. Ndërsa për industrinë përpunuese treguesi u rrit me 22.4 për qind, krahasuar me tremujorin e parë të vitit.

Tendencë të kundërt ka manifestuar industria nxjerrëse e mineraleve. Prodhimi mall i shitur rezultoi afro 68 për qind më i ulët se tremujori i parë ose sa 15 për qind e parashikimit tremujor. Do të vinim në dukje se për tremujorin e dytë të këtij viti industria minerare e nxjerrjes së bakrit nuk ka arritur të vjelë asnjë të ardhur nga prodhimet e veta, ndërkohë që ajo e nxjerrjes së qymyreve dhe mineraleve

---

<sup>6</sup> Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Drejtoria e Programim Zhvillimit, korrik 2001.

të tjera vazhdon të jetë e paralizuar edhe për këtë tremujor, si edhe në periudhat pararendëse.

Megjithatë, si gjashtëmujor prodhimi mall i shitur regjistroi vlerën e 8.4 miliardë lekëve ose 20 për qind më pak se një vit më parë.

Indeksi i vëllimit të prodhimit industrial, rezultoi afro 43.9 për qind<sup>7</sup>. Në fakt, ai është më i lartë se një tremujor më parë në masën 30.3 për qind. Ndërkohë që tendenca rënëse del më në pah kur krahasohen periudha të njëjta. Konkretisht, indeksi i prodhimit industrial ka shënuar rënie të theksuar këtë tremujor, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë me afro 27.4 për qind.

Vihet re se rritja e indeksit të volumit të prodhimit industrial nga tremujori i parë në të dytin e vitit 2001, është pothuajse e njëjtë me rritjen e treguesit të prodhimit mall të shitur. Konvergimi i të dy treguesve, thuajse në të njëjtën vlerë, tregon se, deri-diku, niveli i prodhimit të realizuar gjatë tremujorit të dytë ka arritur të thithë në mënyrë të kënaqshme të ardhurat nga shitja e tij.

Tabela 3: Ecuria e prodhimit industrial.

Indeksi i prodhimit industrial (në % kundrejt vitit 1993)	2000		2001	
	T 2	T1 <sup>8</sup>	T 2	T 2/T1 (në %)
Prodhimi industrial në volum	60.5	33.7	43.9	130.3
- Industria nxjerrëse	32.9	28.8	29.1	101.1
- Industria përpunuese	50.9	16.9	33.6	198.8
- Prodhimi i energjisë elektrike	153.5	117.8	116.5	98.9

Burimi: INSTAT.

Për industrinë nxjerrëse, do të theksonim se ndonëse këtë tremujor është prodhuar më shumë se në tremujorin e parë (+1.1 për qind), nuk është arritur të shitet produkti i prodhuar. Kjo situatë paralajmëron për grumbullime stoqesh të konsiderueshme, që do të thotë, reduktim i mundësive për rritje prodhimi në të ardhmen.

### II. 3. 2. Sektori privat.

Bazuar në disa tregues<sup>9</sup> të investimeve, të kërkesës së brendshme, të tregtisë së jashtme, si edhe informacione të tjera të grumbulluara nga degë të ndryshme të ekonomisë për sektorin privat, mund të vlerësojmë se tendenca e gjallërimit të tij

<sup>7</sup> Konjuktura, Tregues Kryesorë Makroekonomikë, prill-qershor 2001, INSTAT.

<sup>8</sup> Të dhënat e tabelës për tremujorin e parë të vitit 2001 nuk përputhen me ato të publikuara në Buletinin Ekonomik, Qershor 2001, faqe 9, tabela 1, për shkak të rishikimit të shifrave nga njësia përkatëse në INSTAT.

<sup>9</sup> Konjuktura, Tregues Kryesorë Makroekonomikë, prill-qershor 2001, INSTAT.

vazhdon të jetë në rritje. Madje në tremujorin e dytë prirja rritëse është edhe më e theksuar se periudha paraardhëse. Një nga arsytet madhore që ka përcaktuar këtë gjallërim të dukshëm të këtij sektori, vlerësohet të jetë sasia më e madhe e investimeve të përqëndruara kryesisht në tremujorin e dytë të vitit 2001.

Tabela 4: Ecuria e sektorit privat të ekonomisë.

Treguesit indirektë	Njësia e matjes në:	2000	2001					T 2/T1 (në %)
		T 2	T1	T 2	Prill	Maj	Qershor	
<b>Investimet</b>								
- Importi i makinerive dhe pajisjeve	Mld lekë	7.3	8.7	11.7	3.4	3.9	4.2	134.5
- Konsumi i dukshëm i çimentos	mijë tonë	348.5	267	506.4	88.8	112.4	305.24	189.7
<b>Kërkesa e brendshme</b>								
- Konsumi i energjisë elektrike	mldn këh	360	502	502	167	171	164	100.0
- Konsumi i karburanteve	mijë tonë	52.9	73.8	78.9	38.2	29.8	10.8	106.9
- Importe pajisjesh								
- Importe elektroshtëpiake	mijë	21.3	10.8	16.5	1.8	7.8	6.9	152.8
- Importe autoveturash	mijë	11.1	7.6	3.4	1	1.1	1.3	44.7
<b>Tregtia e jashtme</b>								
- Totali i eksporteve	mld lekë	9.9	11.3	13.0	4.6	4.1	4.3	115.0
- Totali i importeve	mld lekë	37.4	41.2	47.9	15.5	15.7	16.7	116.3
- Export/Import	%	26.50	27.4	27.2	29.9	26.1	25.7	99.3

Burimi: INSTAT.

**Importi i makinerive dhe pajisjeve** për këtë tremujor është rritur me afro 34.5 për qind krahasuar me tremujorin e parë të vitit ose 60 për qind më shumë se një vit më parë. **Konsumi i çimentos** flet për afro dyfishim të përdorimit në këtë tremujor krahasuar me të mëparshmin ose një rritje prej 45.3 për qind, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti parë.

Të dy këta tregues dëshmojnë se, në përgjithësi, investimet janë rritur ndjeshëm, madje kemi të bëjmë me një prirje tashmë të qartë nga njëri vit në tjetrin. Ecuria mujore e këtyre treguesve përgjatë tremujorit të dytë flet, gjithashtu, për rritje në vijim për periudhën prill-qershor 2001, ndërkohë që përqëndrimet më të spikatura u shfaqën në muajt qershor. Ky fenomen është mjaft i shprehur për treguesin e konsumit të çimentos, i cili në qershor rezultoi përkatësisht 2.7 dhe 3.4 herë më i lartë se në muajin maj dhe prill. Shifrat flasin për një përqëndrim të dukshëm të investimeve në gjysmën e dytë të gjashtëmujorit të parë të vitit.

Përsa i takon **treguesve të kërkesës së brendshme**, nëse krahasohen shifrat e dy tremujorëve të këtij viti, spikasin rritjet në importet e pajisjeve elektroshtëpiake dhe të konsumit të karburanteve. Sidoqoftë, vazhdojmë të përforcojmë idenë se, përgjithësisht, tregu ka arritur të ketë njëfarë ngopjeje me produkte të tilla, përderisa tendenca rënëse evidentohet ende kur krahasohen shifrat e periudhave raportuese për dy vitet në vijim. Kështu, krahasuar me një vit më parë, tremujori i dytë i vitit 2001, ka shënuar një pakësim të importit të këtij grup-produkti në afro 22.5 për qind.

**Konsumi i energjisë elektrike** ka mbetur në të njëjtat nivele si edhe një tremujor më parë, ndërkohë që krahasuar me tremujorin e dytë të vitit 2000, ka pësuar një



rritje prej 39.4 për qind. Përgjithësisht, vlerësohet që ulja e humbjeve në rrjet, administrimi më i mirë i shpërndarjes së energjisë si dhe rritja e nevojave për konsum kanë çuar në rritje të konsumit të energjisë elektrike. Madje, në kushtet e mungesës së burimeve të tjera energjitike, kjo rritje vlerësohet të kthehet në një tendencë. Ndaj, në situatat e vështira energjitike që kalon vendi, është e domosdoshme të hartohen politika që mbështesin gjetjen e burimeve zëvendësuese apo alternative të energjisë elektrike, krahas masave për rregullimin e burimeve të energjisë elektrike dhe të rrjetit shpërndarës.

Evidentohet si një prirje edhe rënia e **importit të autoveturave**. Kjo rënie mund të shpjegohet, si për efekt të fenomenit “ngopje e tregut”, ashtu edhe si rritje e preferencave të konsumatorëve për të patur në zotërim autovetura me moshë sa më të re, të cilat kushtojnë shumë. Ndoshta, edhe ky element i sjelljes konsumatore, ka ndikuar në kufizimin e fluksit të hyrjes së autoveturave.

Ndërsa treguesit kryesorë të **tregtisë së jashtme**, flasin për një ecuri në rritje si të eksporteve ashtu edhe të importeve, duke synuar drejt një rritjeje të koeficientit të mbulimit të eksporteve me importe. Sidoqoftë, sasia e importeve qëndron në nivele disa herë më të larta se ajo e eksporteve. Kështu, për tremujorin e dytë ky tregues rezulton afro katër herë më shumë importe se sa eksporte. Nga ana tjetër, nëse do të krahasonim treguesin: **vëllimi tregtar në raport me PBB-në**, për gjashtëmujorët e parë të viteve 2000 dhe 2001<sup>10</sup>, do të konkludonim se ekonomia shqiptare vazhdon të bëjë përpjekje drejt një hapeje më të madhe (përkatësisht ky tregues për këto dy periudha rezultoi 16.4 dhe 19.3 për qind).

## II. 4. Ndërtimi<sup>11</sup>

Periudha pranverë-verë është periudha në të cilën sektori i ndërtimit ka manifestuar rritje të konsiderueshme në aktivitetin të tij. Por, ky efekt sezonal pozitiv, nuk është ndjerë sa pritej në tremujorin e dytë të vitit 2001. Në kushtet e një informacioni jo të plotë statistikor për këtë sektor të rëndësishëm të ekonomisë, gjykohet se ndërtimi nuk ka ecur me të njëjtat ritme zhvillimi sikurse gjatë tremujorit të parë të vitit. Do të ishte e natyrshme të pritej një rritje akoma më e madhe e ritmit të ndërtimeve në tremujorin e dytë, për faktin se në investimet publike në fushën e infrastrukturës në zonat urbane dhe suburbane, kanalizime etj., u realizua një shtesë fondesh prej 1.4 miliardë lekësh.

Në sektorin publik për tremujorin e parë dhe të dytë, investimet në ndërtim, janë realizuar përkatësisht 125.9 dhe 23.4 për qind, ndaj parashikimeve për to. Ndërkohë që për gjashtëmujorin e parë 2001 investimet janë realizuar në masën 74 për qind, krahasuar me parashikimin e tyre për gjysmën e parë të vitit. Vihet re një situatë joritmike në kryerjen e tyre. Përkatësisht sipas tremujorëve të parë dhe të dytë, janë kryer 84 dhe 16 për qind e totalit të regjistruar gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit.

<sup>10</sup> PBB për vitin 2001 është marrë sipas parashikimit.

<sup>11</sup> Burimi i informacionit për sektorin e ndërtimit: Ministria e Punëve Publike.

Tabela 5: Realizimi i investimeve në përqindje ndaj programit.

Investimet	Tremujori I 2001	Tremujori II 2001	Gjashtëmujori I 2001
Investime gjithsej	125.9	23.4	74.1
Ndërtim-Montim	159.7	9.1	74
Makineri-Pajisje	17.8	65.3	29.2
Studime e projektme	36.5	99.6	69.2
Investime të tjera*	....	....	....

Shënim: \* Nuk disponohen të dhëna për këtë zë të investimeve.

Financimet e huaja gjatë gjithë gjashtëmujorit kanë qenë nën nivelin e parashikuar. Ato janë përdorur vetëm për kategorinë “ndërtim - montime”. Vlerësohet se pesha stokut të kredisë bankare për sektorin e ndërtimit, deri në fund të muajit qershor 2001, ka zënë një vend të konsiderueshëm, afro 27 për qind të stokut total të saj.

Tabela 6: Financimi i investimeve në përqindje ndaj programit.

Investimet	Tremujori I 2001	Tremujori II 2001	Gjashtëmujori I 2001
Financime buxhetore:	157.6	20.5	79.1
Ndërtim-Montim	228.7	3.2	80.8
Makineri-Pajisje	17.8	65.3	29.2
Studime e projektme	36.5	99.6	69.2
Investime të tjera*	....	....	....
Financime të huaja:	63.7	40.6	56
Ndërtim-Montim	63.7	40.6	56

Shënim:\* Nuk disponohen të dhëna për këtë zë të investimeve.

Një element tjetër, që vlen të analizohet është edhe dhënia e licencave për shoqëritë e ndërtimit. Ky element njëherësh informon edhe mbi pritshmëritë e këtij aktiviteti. Konstatohet se gjatë tremujorit të dytë dhënia e licencave nuk ka pësuar ndryshime të dukshme. Ajo ka manifestuar të njëjtat ritme si edhe në tre muajt e parë të vitit. Përsa i takon ecurisë mujore të dhënies së licencave, do të dallohej muaji prill me numrin më të lartë të lëshimit të tyre, 35. Ndërkohë që, gjatë gjysmës së parë të vitit 2001, Ministria e Punëve Publike ka licencuar 185 shoqëri ndërtimi, nga të cilat 13 janë të huaja. Nëse do të hidhnim një vështrim në shpërndarjen gjeografike të tyre, vëmë re se këto shoqëri janë përqëndruar kryesisht në rrethin e Tiranës (84, nga të cilat 13 janë shoqëritë e huaja), e ndjekur nga Korça, Kruja, Shkodra dhe Durrësi etj.. Kuptohet që përqëndrimi i tyre në kryeqytet është i natyrshëm, për vetë aktivitetin e madh ekonomik dhe social që vlerësohet të ketë qyteti i Tiranës.

Treguesi i indeksit të kushtimit në ndërtim është rritur me 0.81 për qind, kundrejt tremujorit të parë të vitit 2001 dhe 8.5 për qind krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Në këtë rritje ndikimin më të madh e ka patur grupi “shpenzime direkte”, i cili ka shënuar një rritje prej 1.5 për qind në krahasim me një tremujor

më parë dhe 11.8 për qind në krahasim me një vit më parë. Në këtë grup, rritje më të madhe ka patur nëngrupi “shpenzime për paga” me 5.3 për qind krahasuar me tremujorin e parë dhe 18.8 për qind krahasuar me tremujorin e dytë të vitit 2000. Ky është nëngrupi që mesatarisht ka pësuar rritjet më të mëdha nga njëri tremujor në tjetrin.

Nga ana tjetër, norma e fitimit këtë tremujor shënoi një ulje prej 0.5 për qind krahasuar me tremujorin e kaluar. Në nivel gjashtëmujor, ajo është rritur me rreth 1.4 për qind krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Investimet publike të degës së ndërtimit në infrastrukturën rurale, urbane, energji elektrike, ujësjellësa dhe në rrjetin e kanalizimeve janë të pranishme edhe në këtë pjesë të parë të vitit. Megjithëse vërehet të ketë ende hapësira, do të theksonim se niveli i realizimit të tyre është më i lartë se çdo vit tjetër.

Tabela 7: Realizimi i investimeve sipas destinacionit (për gjashtëmujorin e parë 2001).

Investimet	Realizimi (në %)
Investimet e brendshme në ujësjellësa	92
Investimet nga donatorë të huaj në ujësjellësa	99
Investimet për kanalizime	102
Investimet për sistemim, asfaltim rrugësh	85

Megjithë informacionin më sipër për këtë sektor, jemi të mendimit se përsëri ai vazhdon të mbetet i rëndësishëm dhe produktiv në ekonomi. Ndoshta, disa shenja “ngopjeje” të kërkesës për konsum ndërtimor<sup>12</sup>, vijimi i zbatimit të masave administrative kundra ndërtimeve pa leje, si edhe rillogaritja e TVSH-së, po bëjnë që ky sektor të fillojë të manifestojë reduktim të ritmeve të rritjes.

## II. 5. Transporti<sup>13</sup>.

### II. 5. 1. Investimet

Në tremujorin e dytë të vitit 2001, vihen re disa arritje të dukshme pozitive. Investimet në total u realizuan me rreth 17 për qind mbi parashikimin për këtë tremujor. Ndërsa si nivel gjashtëmujor, treguesi i investimeve për sektorin e transportit, në totalin e tij është realizuar me rreth 4.6 pikë përqindjeje më lart se programi. Po kështu, vetëm në këtë gjashtëmujor janë realizuar rreth 31.6 për qind e investimeve të parashikuara për gjithë vitin 2001.

Nëse analizojmë burimin e investimeve, vlen të përmendet fakti se investimet nga burime buxhetore kanë një mosrealizim në masën 6.42 për qind, ndërsa ato të mbuluara nga ndihma e kredi, janë realizuar mbi parashikimin për këtë gjashtëmujor, në masën 11.9 për qind.

<sup>12</sup> Sipas Entit Kombëtar të Banesave, megjithëse kërkesa për banesa nuk ka shfaqur tendenca rritëse, ajo mbetet përsëri në nivele të larta.

<sup>13</sup> Burimi i të dhënave për sektorin e transportit: Ministria e Transportit.

Realizimi i totalit të investimeve në këto nivele, paraqet këto karakteristika:


- *së pari*, ka një shpërndarje jouniforme të parashikimit të investimeve gjatë vitit;
- *së dyti*, ka një tendencë në rritje të nivelit të realizimit të tyre;
- *së treti*, ka një tejkallim të treguesit të investimeve përkundrejt parashikimeve sidomos për tremujorin e dytë, fenomen i pandeshur vite me rradhë.

Tabela 8: Ecuria e investimeve për vitin 2001 (në miliardë lekë).

Investimet	3-mujori I			3- mujori II			6-mujori I		
	Fakti	Progr.	Realizimi (%)	Fakti	Progr.	Realizimi (%)	Fakti	Progr.	Realizimi (%)
Investime gjithsej:	1.5	1.9	78.6	4.7	4.1	114.6	6.2	6.0	104.6
Buxhetore	0.3	0.7	42.6	1.8	1.6	112.5	2.2	2.4	93.6
Ndihma e kredi	1.2	1.1	101	2.9	2.5	116	4.0	3.6	111.9

Nëse analiza e këtij treguesi do të shtrihej edhe në aspektin e destinacionit të përdorimit të burimeve të investimeve për gjashtëmujorin e parë të vitit 2001, shifrat do të dëshmonin për realizime dhe tejkallime në të gjitha destinacionet e burimeve të huaja, ndërkohë që, për disa zëra të burimeve buxhetore ndeshen mosrealizime. Megjithatë, mosrealizimet janë pasojë e nivelit të lartë të mosrealizimeve në tremujorin e parë, pasi në tremujorin e dytë ka tejkallime. I rëndësishëm është fakti që për të dyja llojet e burimeve që mbulojnë investimet, ato për ndërtim-montime dhe për makineri-pajisje, pra që lidhen drejtpërsëdrejti me aspektin prodhues të degës së transportit, shënojnë shifra tejkallimesh dhe realizimesh të kënaqshme, në raport me parashikimin gjashtëmujor.


Grafiku 2: Realizimi i investimeve në gjashtëmujorin e parë të vitit 2001.




Interes paraqet pamja e strukturës së këtyre investimeve për të dyja llojet e burimeve për tremujorin e dytë të vitit sipas destinacioneve. Ndërtim-montimet realizohen në

pjesën më të madhe nga burime të huaja.

Grafiku 3: Struktura e investimeve të huaja sipas destinacionit në tremujorin II të vitit 2001.



Grafiku 4: Struktura e investimeve buxhetore sipas destinacionit për tremujorin II 2001.



Vetëm në infrastrukturën rrugore janë investuar për këtë gjashtëmujor rreth **6.6 miliardë lekë**, që do të thotë se, krahasuar me investimet gjithsej të kryera për këtë periudhë ato kanë zënë peshën më të madhe në strukturën e tyre, afro 90.4 për qind të totalit të investimeve. Ndërsa, krahasuar me parashikimin për këto investime (rrugore) për gjysmën e parë të vitit **ato janë tejkaluar me afro 370 milionë lekë ose 5.93 për qind më shumë se sa ky parashikim.**

Nëse do të përmbledhej i gjithë informacioni rreth investimeve të kryera për tremujorin e parë dhe të dytë të vitit 2001, bie në sy përqëndrimi i lartë i tyre në tremujorin e dytë.

Tabela 9: Ritmi i rritjes së investimeve në tremujorin e dytë në krahasim më të parin e vitit 2001 (në herë).

Treguesi (në herë)	Sipas realizimit faktik	Sipas parashikimit
Investime gjithsej:	2.1	1.1
- buxhetore	4.9	1.1
- ndihma e kredi të huaja	1.4	1.1

## II. 5. 2. Vëllimi i punës

Për të kryer një analizë të plotë në lidhje me vëllimin e punës së kryer në degën e transportit duhet gjykuar mbi disa tregues njëkohësisht.

Tabela 10: Vëllimi i punës në transportin e mallrave për gjashtëmujorët e parë të viteve 2000 dhe 2001.

Në milionë /ton km	2000	2001	2001/2000 (në %)
Llojet e transporteve:	105.9	136.1	128.4
- Automobilistik*	.....	.....	.....
- Hekurudhor	13.9	10.3	73.6
- Detar e ujq	92.0	125.8	136.7

Shënim: \*Për gjashtëmujorët e parë të viteve 2000 dhe 2001 nuk disponohen të dhënat e plota për transportin automobilistik.

Ndonëse të dhënat nuk janë të plota për dy periudhat gjashtëmujore të dy viteve të fundit, **treguesi i vëllimit të punës në transportin e mallrave** për periudhën janar-qershor 2001, ka shënuar një rritje prej afro 28.4 për qind në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Ky fakt dëshmon për një lëvizshmëri, në mënyrë të konsiderueshme më të lartë të ekonomisë, krahasuar me gjashtëmujorin e parë të vitit 2000.

Treguesi i **vëllimit të punës për transportin e udhëtarëve**. Për të gjitha llojet e transporteve, paraqitet një rënie e treguesit të vëllimit të punës së transportit të udhëtarëve, me afro 8.4 për qind.

Tabela 11: Vëllimi i punës në transportin e udhëtarëve për gjashtëmujorët e parë të viteve 2000 dhe 2001.

Në milionë /udhëtarë km	2000	2001	2001/2000 (në %)
Llojet e transporteve:	127.7	116.9	91.6
- Automobilistik*	.....	.....	.....
- Hekurudhor	64.1	64.6	100.7
- Detar e ujqor	10.1	0.2	.....
- Ajror	53.5	52.2	97.6

Shënim:\* Për gjashtëmujorët e parë të viteve 2000 dhe 2001 nuk disponohen të dhënat e plota për transportin automobilistik dhe ujqor.

Në **transportin ajror**, vërehet një ecuri në rritje me ritme të larta në gjashtëmujorin e parë të vitit. Trend pozitivisht më të lartë ka manifestuar treguesi i numrit të avionëve dhe mbikalimeve ajrore.

Tabela 12: Ecuria e transportit ajror në gjashtëmujorët e parë të viteve 2000 dhe 2001.

Nr.	Treguesit	Njësia e matjes	6-mujori I 2000	6-mujori I 2001	2001/2000 (në %)
1	Shoqëri ajrore	Shoqëri	10	10	100.0
2	Avionë gjithsej - Mbikalime	Avionë "	29585 26913	34629 32057	117.1 119.1
3	Transport udhëtarësh	Udhëtarë	184901	204589	110.6
4	Mallra dhe posta	Tonë	694	801	115.4

Një tregues tjetër domethënës i volumit të punës në transport është, gjithashtu, **vëllimi i punës së ngarkim-shkarkimit**, në hekurudha dhe porte detare.

Tabela 13: Vëllimi i punës së ngarkim-shkarkimit.

Vëllimi i ngarkim-shkarkimit (në mijë tonë fizikë)	6-mujori I 2000	6-mujori I 2001	2001/2000 (në %)
Hekurudha	197.6	91.1	46.1
Porte	1321.4	1419.5	107.4
Gjithsej	1519	1510.6	99.5

Shifrat flasin për një ritëm të lartë pune nëpër porte. Ky gjashtëmujor ka shënuar një rritje prej afro 7.4 për qind krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Ky fakt dëshmon për një hyrje dhe dalje mallrash në nivele të larta, pra për një aktivitet në rritje të import-eksportit dhe të lëvizjeve të brendshme. Më i dukshëm ky fenomen është për Portet e Durrësit, të Vlorës dhe të Shëngjinit, tre nga nyjet e rëndësishme të infrastrukturës ujore në vend. Përkatësisht rritjet për periudhat përkatëse janë 0.4, 18 dhe 59 për qind.

**Box 1: Karakteristika të ecurisë së ritmeve të aktivitetit të transportit për periudhën 1996-2000.**

Duke gjykuar për nga gjerësia, larmia dhe dobia e produkteve dhe shërbimeve që ofron transporti, mund të konsiderohet si një nga sektorët jetikë të ekonomisë. Kontributi i tij në PBB, që nga viti 1997 ka njohur rritje. Në vitin 2000 transporti përbënte 3.5 për qind të prodhimit të brendshëm bruto. Në këtë trajtim të përgjithshëm në lidhje me industrinë e transportit, do të na vinte si një ndihmë e parë, emërtimi i tij<sup>14</sup>, i cili në fund të fundit është tregues i qëllimit të këtij aktiviteti. E thënë ndryshe, ky sektor siguron vijueshmërinë dhe finalizimin e proceseve të panumëra që vënë në lëvizje ekonominë dhe shoqërinë e një vendi. Kështu, pa një infrastrukturë rrugore të zhvilluar, nuk mund të ekzistojë një zhvillim harmonik, racional dhe normal i të gjitha llojeve të transportit, për pasojë edhe i kushteve optimale për zhvillimin e të gjitha degëve të tjera të ekonomisë.

Duke qënë pjesë e pandarë e infrastrukturës, sa herë që bëhen përpjekje për zhvillimin dhe çuarjen përpara të saj, po aq herë, madje shpesh edhe më seriozisht, duhet menduar për perfeksionime dhe risi në sektorin e transportit.

Shifrat dhe faktet që disponohen për ecurinë në vite të treguesve më të rëndësishëm në degën e transportit, flasin për përparësinë që i është kushtuar, asaj, nga autoritetet përkatëse.

Nga ana tjetër, kjo degë i është nënshtruar, pothuajse plotësisht, procesit të privatizimit, kryesisht në transportin automobilistik, detar, hekurudhor dhe ajror, nëpërmjet transformimit të pronësisë nga shtetërore në shoqëri aksionere (Sh.A).

Ecuria e përgjithshme në aktivitetin e transportit përgjatë periudhës 1996-2000, ka manifestuar tendenca pozitive. Në disa raste ato kanë qenë të theksuara dhe në raste të tjera, më pak të theksuara.

Sipas llojeve të transporteve ritmet e rritjes së aktivitetit të kësaj dege në vite paraqesin disa veçori:

- a) transporti i mallrave për transportin hekurudhor dhe atë detar e ujqor ka njohur rritje më të konsiderueshme se sa transporti i udhëtarëve;
- b) transporti ajror është karakterizuar nga rritje të theksuara të numrit të udhëtarëve, kryesisht në dy vitet e fundit. Megjithatë, rritjet më të ndjeshme ndeshen në treguesin e numrit të avionëve që kalojnë në rrugët ajrore shqiptare (mbikalimet);
- c) të gjitha llojet e transporteve njohën rënie drastike, si për transportin e udhëtarëve ashtu edhe për atë të mallrave, gjatë krizës së pranverës së vitit 1997. Periudha që pasoi, shërbeu për rimëkëmbjen të këtij sektori për të kapur shifrat e parakrizës;
- d) pas vitit 1997, vihet re një rritje edhe më e shpejtë në aktivitetin e volumit të punës në transport, fakt që i dedikohet, deri në njëfarë mase, ritmeve më të shpejta të procesit të privatizimit, si edhe rritjes së shkallës së investimeve në këtë sektor;
- e) vihet re se ritmet e rritjes së treguesve kryesorë ekonomikë në degën e transportit, janë më të ulëta, përballë ritmeve të rritjes së investimeve nga burime të brendshme dhe të huaja. Ky fakt tregon se investimet e kryera japin efekte të konsiderueshme për një periudhë më të vonshme. Natyra e këtyre investimeve ka, përgjithësisht, efekt që shtrihet për periudha

<sup>14</sup> Fjala "transport", përfshin njëkohësisht, dy momente, lëvizjen dhe mbajtjen e një ngarkese, (produkte, mallra, njerëz etj.) nga njëri vend në tjetrin.



afatgjata. Ndërkohë që nuk duhet lënë larg vëmendjes fakti se ndoshta, një pjesë e tyre nuk janë kryer me eficiencë. Kjo bën që ritmet mesatare të rritjes së treguesve ekonomikë të sektorit të transportit, të mos arrijnë nivelet e pritura.

Nëse do të hidhnim një vështrim të shpejtë mbi strukturën e kryerjes së investimeve nuk është e vështirë të vërehet një rritje e ndjeshme e investimeve nga njëri vit në tjetrin. Ndërkohë që, për burimet e huaja të investimeve ritmi i rritjes nga njëri vit në tjetrin paraqitet më i rregullt dhe deri diku konstant, për ato buxhetore ky ritëm paraqet luhatje të dukshme në rënie.

Sidoqoftë, pjesa më e madhe e këtyre investimeve në vite është përballuar nga burimet huaja (ndihma apo kredi). Madje, nëse do t'i referohemi shifrave, raporti mesatar ndërmjet burimeve të huaja dhe atyre buxhetore të mbulimit të investimeve qëndron në masën rreth 2.9 herë më shumë në vit, në favor të burimeve të huaja.

**Tabela 14: Ecuria e investimeve.**

Investimet (miliardë lekë)	1997	1998	1999	2000
Investime gjithsej:	3.8	8.3	13.1	16
Buxhetore	0.6	2.0	4.4	6.0
Ndihma e kredi	3.2	6.3	8.7	10

Nëse i referohemi treguesit të **vëllimit të punës në transportin e mallrave dhe të udhëtarëve** vërehet:

- në transportin e mallrave ka një prirje të qartë rritjeje ;
- në transportin e udhëtarëve tendenca rritëse ka qenë graduale për të gjitha llojet e transporteve. Përfundimisht në vitin 1998, pasi në vitin 1997 ka patur një mpirje të qarkullimit të udhëtarëve;
- në transportin ajror, gjithashtu, ka rritje të vazhdueshme.

**Tabela 15: Vëllimi i punës në transportin e mallrave për gjashtëmuorët e parë sipas viteve.**

Në milionë /ton km	1997	1998	1999	2000*
Llojet e transporteve:	537.41	1025.7	1075.3	105.93
- Automobilistik	440	924.7	980	.....
- Hekurudhor	10.41	10.78	13.3	13.93
- Detar e ujqor	87	90.2	82	92

Shënim:\*Për gjashtëmuorin e parë të vitit 2000 nuk disponohen të dhënat e plota për transportin automobilistik.

**Tabela 16: Vëllimi i punës në transportin e udhëtarëve për gjashtëmuorët e parë sipas viteve.**

Në milionë /udhëtarë km	1997	1998	1999	2000*
Llojet e transporteve:	153.66	1259.6	2086.9	127.65
- Automobilistik	94.46	1161	1970	.....
- Hekurudhor	36.3	54.1	56.9	64.14
- Detar e ujqor	5.7	10.5	11.7	10.051
- Ajror	17.2	34	48.3	53.46

Shënim: \*Për gjashtëmuorin e parë të vitit 2000 nuk disponohen të dhënat e plota për transportin automobilistik.

**Tabela 17: Ecuria e transportit ajror në gjashtëmujorët e parë sipas viteve.**

Nr.	Treguesit	Njësia e matjes	1997	1998	1999	2000
1	Shoqëri ajrore	Shoqëri	13	13	12	10
2	Avionë gjithsej - Mbikalime	Avionë “	8416 6821	11805 9874	8389 2732	29585 26913
3	Transport udhëtarësh	Udhëtarë	109401	132265	139970	184901
4	Mallra dhe posta	Tonë	537	504	406	694

## II. 6. Tregu i punës<sup>15</sup>.

Tremujori i dytë vazhdon të reflektojë përmirësime të treguesve të tregut të punës. Shkalla e papunësisë, edhe për këtë periudhë të vitit, ka shënuar rënie. Vlera e saj arriti në 15.1<sup>16</sup> për qind duke numëruar 13 mijë të papunë më pak se tremujori i parë i vitit. Afro 84.9 për qind e forcës së aftë për punë ka patur mundësinë që gjatë tremujorit të dytë të vitit të ketë qenë e punësuar.

Rënia e shkallës së papunësisë prej mëse 0.86 pikë përqindjeje në krahasim me tremujorin e parë, mund të interpretohet me rritjen e mundësive për të punuar, për shkak të hapjes së vendeve të reja të punës në këtë tremujor. Megjithëse të dhënat e plota mungojnë për sa i takon punësimeve të reja, mund të vlerësojmë se, kryerja e një sërë investimesh, kryesisht në infrastrukturën rrugore, ka dhënë ndikim pozitiv në rritjen e nivelit të zënies me punë.

Tabela 18: Papunësia në tremujorin e dytë të vitit 2001.

Treguesit (në mijë)	2000		2001			
	T 2	T 1	T2	Prill	Maj	Qershor
Të papunë gjithsej	228	205	192	197	191	189
Përfitojnë pagesë papunësie	22	21	18	21	17	17
Shkalla e papunësisë (në %)	17.6	15.96	15.1			

Burimi: INSTAT.

Tendenca rënëse e shifrës së të papunëve është tipar i gjithë tremujorit të dytë. Rënia e treguesve të papunësisë shoqëron edhe shifrën e personave që përfitojnë pagesë papunësie. Kjo do të thotë që afro 3 mijë persona që nuk përfitojnë më pagesë papunësie, të kenë filluar të paktën një punë.

Tabela 19. Punësimi në tremujorin e parë të vitit 2001.

Treguesit (në mijë)	Trem. I 2001	Trem. II 2001	Trem. II 2000
Forca e punës	1283	1269	1293
-Të punësuar gjithsej	1078	1077	1065
Nga këta:			
- në sektorin shtetëror	198	197	201
- në sektorin privat jobujqësor	119	119	103
- në sektorin privat bujqësor	761	761	761

Burimi: INSTAT.

Ndërsa situata e të punësuarve në sektorin privat jobujqësor dhe atë bujqësor<sup>17</sup> nuk ka shënuar asnjë ndryshim, gjendemi përballë një situatë joreale, nëse marrim parasysh rezultatet paraprake të regjistrimit të popullsisë në prill të vitit 2001. Nga këto të dhëna rezulton se popullsia në zonat rurale që nga viti 1989 e deri më sot, ka rënë me 257.6 mijë banorë<sup>18</sup> ose me 12.6 për qind. Së pari, kjo rënie nuk mund të argumentojë rritjen e të punësuarve në sektorin privat bujqësor që nga viti 1995 e deri më sot me afro 200 mijë vetë. Së dyti, rënia e

<sup>15</sup> Burimi i të dhënave për tregun e punës: INSTAT.

<sup>16</sup> Konjuktura, Tregues Kryesorë Makroekonomikë, prill-qershor 2001, INSTAT.

<sup>17</sup> Sektori privat bujqësor prej disa vjetësh nuk regjistron ndryshime.

<sup>18</sup> "Rezultate paraprake të regjistrimit të popullsisë dhe banesave 2001", INSTAT.

numrit të popullsisë në zonën rurale nuk mund të argumentojë për më tepër ruajtjen konstant të numrit të të punësuarve në sektorin privat të bujqësisë. Së *treti*, lëvizjet migratore të popullsisë nga fshati në qytet, vlerësohet të jenë të vazhdueshme, fakt që flet që edhe numri i të punësuarve në sektorin bujqësor të paktën nuk mund të mbetet konstant, por duhet të shkojë drejt rënies së vazhdueshme.

### III. Zhvillimet fiskale

Statistikat e buxhetit të shtetit<sup>19</sup> edhe për tremujorin e dytë të vitit 2001, pasqyruan punën serioze të organeve shtetërore në drejtim të vjeljes së të ardhurave dhe të realizimit të shpenzimeve në shifra tejet të larta. Ndërsa, për realizimin e të ardhurave kemi disa kohë që përballemi me shifra rreth 100 për qind, për zërin e shpenzimeve do të pohojm pa asnjë hezitim, që është hera e parë, që ndeshemi me një fenomen të ri, atë të rritjes së konsiderueshme të nivelit të realizimit të parashikimeve për shpenzimet. Është krejtësisht normale që mbi shifra të tilla realizimesh të gjykohej, se gjatë tremujorit të dytë të vitit 2001 është ndjekur një politikë fiskale e qëndrueshme.

Tabela 20: Ritmika e të ardhurave dhe shpenzimeve mujore për gjashtëmujorin e parë të vitit 2001.

Të ardhurat (në miliardë lekë)	Janar 2001	Shkurt 2001	Mars 2001	Prill 2001	Maj 2001	Qershor 2001	Qershor 2001 (plani)	Korrik 2001
Totali i të ardhurave.	7.1	10.9	12.0	13.1	11.0	11.7	11.0	11.5
Totali i shpenzimeve	10.8	11.2	13.8	13.2	15.5	19.7	16.7	15.9
Zërat kryesorë:								
- korrente	9.8	9.8	11.6	10.4	12.0	12.6	11.4	12.4
- kapitale	1.1	1.2	2.2	2.8	3.6	6.0	3.5	3.6

#### III. 1. Të ardhurat buxhetore.

Vetëm gjatë tremujorit të dytë të vitit 2001 në buxhetin e shtetit u derdhën afro 35.8 miliardë lekë. Në krahasim më tremujorin e parë, shifra e të ardhurave totale të këtij tremujori, në vlerë absolute, rezultoi 5.9 miliardë lekë më shumë ose 19.7 për qind më e lartë. Krahasuar me parashikimin për tremujorin e dytë të ardhurat janë tejkaluar me afro 6 për qind.


Analiza e zërave kryesorë të të ardhurave, tregon se të ardhurat tatimore për tremujorin e dytë, kanë shënuar një shifër më të lartë se një tremujor më parë me rreth 7.4 për qind të ardhura tatimore më shumë. Në të njëjtën kohë edhe të ardhurat jotatimore qëndrojnë në nivele shumë më të larta se tremujori i parë i

<sup>19</sup> Burimi i të dhënave për zhvillimet fiskale: Ministria e Financave.

vitit 2001. Shifra e këtij grupi të ardhurash është rreth 2.4 herë më e lartë. Ndërkohë, të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore janë pothuajse në të njëjtat nivele për të dy tremujorët.

Struktura e vjeljes së të ardhurave, vazhdon të qëndrojë në favor të të ardhurave tatimore, të cilat deri në fund të tremujorit të dytë zunë afro 67.6 për qind të të ardhurave totale. Nëse do të analizohet struktura e të ardhurave tatimore, do të evidentoheshin si të ardhura me peshë më të lartë ato të grumbulluara nga organet tatimore dhe doganore duke zënë rreth 97.2 për qind të të ardhurave tatimore. Në degëzimet e pemës së madhe të të ardhurave nga doganat dhe tatimet, evidentohet tatimi mbi vlerën e shtuar, nënçeri më i rëndësishëm me një peshë prej 41.5 për qind të të ardhurave tatimoro-doganore. Qëndrueshmëria e të ardhurave tatimore do të ndihmohet mjaft, nëse rriten përpjekjet për të zhvendosur procesin e mbledhjes së TVSH nga autoritetet doganore tek ato tatimore.

Grafiku 5: Struktura e të ardhurave nga tatim-doganat për tremujorin e dytë të vitit 2001.



### III. 2. Shpenzimet buxhetore.

Realizimi i shpenzimeve buxhetore mori një rëndësi të veçantë në tremujorin e dytë të vitit 2001, në fund të të cilit u zhvilluan zgjedhjet e përgjithshme. E tërë periudha prill-qershor, madje edhe muaji korrik, u përfshinë nga një atmosferë tepër aktive në drejtim të investimeve që ndërmori qeveria, investime që kryesisht prekën sferën e infrastrukturës rrugore<sup>20</sup>. Kuptohet, që realizimi i investimeve të tilla lidhet ngushtë me kryerjen e një sërë shpenzimesh. Këto investime janë përshëndetur tashmë disa herë për dobishmërinë afatgjatë që ato i sjellin ekonomisë. Në të njëjtën kohë, nga ana e bankës qendrore, është

<sup>20</sup> Për detaje, shih pikën II. 5. 1.

tërhequr vëmendja për të patur më shumë kujdes në kryerjen e tyre përgjatë pjesës së mbetur të vitit, në mënyrë që të evitohen në maksimum presionet e mundshme inflacioniste në ekonomi.

Deri në fund të tremujorit të dytë apo të gjashtëmujorit të parë u dëshmuua se, në përgjithësi, u realizua një shkallë e lartë shpenzimesh, ndryshe nga vitet e mëparshme. Nisur nga të dhënat evidentohet se tremujori i dytë i vitit është karakterizuar nga nivele shpenzimesh më të larta se sa tremujori i parë i atij 2001.

Tabela 21: Ecuria e shpenzimeve buxhetore 2001.


Shpenzimet buxhetore (në miliardë lekë)	T. I 2001	T. II. 2001	T.II.2001 sipas programit	Realizimi i shpenzimeve T II (ndaj programit në %)
Totali i shpenzimeve	35.8	48.4	45.7	106
Zërat kryesorë:				
- Shpenzime korrente	31.2	34.9	33.5	104
- Shpenzime kapitale	4.5	12.3	9.6	128

Shihet dukshëm që shpenzimet kapitale paraqesin një rritje këtë tremujor në krahasim më paraardhësin, pothuajse tre herë më shumë. Nga ana tjetër, nëse krahasohet niveli i realizimit të tyre për tremujorin e dytë me programin për këtë tremujor, ndeshen tejkalime të programit të kryerjes së shpenzimeve si për totalin, ashtu edhe për zërat e veçantë. Ky fenomen është më i shprehur në grupin e shpenzimeve kapitale, që kanë të bëjnë kryesisht me shpenzime investuese.

Nëse analizohet ritmika e kryerjes së tyre sipas muajve ajo është e rregullt në totalin e shpenzimeve. Ky fakt nuk evidentohet sipas zërave kryesorë. Bie në sy menjëherë një “kapërcim” i shpenzimeve kapitale në muajin qershor, me afro dyfishin e sasisë mesatare mujore të shpenzimeve të faktuara gjatë pesë muajve të parë të vitit. Njëherësh kjo shifër rezulton afro 71.4 për qind më e lartë se sa parashikimi për muajin qershor 2001. Ky fakt flet edhe një herë për shpenzime apo për investime të përqëndruara në muajin e fundit të tremujorit të dytë, përqëndrim i cili vlerësohet të ndikojë në rritje të presioneve inflacioniste, e cila ndjehet të paktën për tre muajt vijues.

Një paraqitje strukturore e shpenzimeve deri në fund të tremujorit të dytë, tregon se pjesën më të madhe të tyre e zënë shpenzimet korente në masën 78.5 për qind, të ndjekura nga ato kapitale me një peshë ndaj totalit, 19.9 për qind.

Grafiku 6: Struktura e shpenzimeve korente për tremujorin e dytë 2001.



Në ndryshim nga periudhat pararendëse, jemi përballë realizimit të shpenzimeve në nivele mjaft të larta, madje me tejkalime që në zëra dhe nënçera të ndryshëm janë mjaft të dukshme. Deri në fund të

tremujorit e parë u duk sikur përpjekjet e qeverisë ishin frytdhënëse në drejtim të kryerjes nën kontroll të shpenzimeve. Siç duket, në tremujorin e dytë dhe në vazhdim, ky fakt nuk u mbajt aq sa duhet parasysh, ndaj edhe shpenzimet dolën tej kufijve të programuar. Kështu, shpenzimet kapitale në fund të tremujorit të dytë rezultuan 28.1 për qind më të larta se sa parashikimi për to. Ky vlerësohet të jetë një nga faktorët që ndikoi në rritjen e inflacionit për periudhën maj-gusht 2001.

### III. 3. Deficiti buxhetor.

Vlera e deficitit buxhetor në fund të muajit qershor 2001 kapi shifrën e 18.6 miliardë lekëve. Ky deficit u mbulua në masën 43.2 për qind nga burime të brendshme dhe në pjesën tjetër nga burime të huaja. Ndër burimet e brendshme vihet re se të ardhurat nga privatizimi kanë ardhur në rritje të vazhdueshme. Deri në fund të tremujorit të dytë ato kapën shifrën e 9.7 miliardë lekëve duke qenë 3.2 herë më të larta, se sa në tremujorin e parë të vitit. Krahasuar me parashikimin për të deri në qershor të vitit 2001, ai u realizua në masën 84.2 për qind.

Akti normativ lidhur me disa ndryshime në ligjin “Për buxhetin e shtetit”, i miratuar në fillim të muajit shtator 2001, mbështet idenë e rritjes së të ardhurave të parashikuara deri në fund të vitit edhe me afro 5 miliardë lekë të tjera, ndërkohë që parashikon edhe rritjen e shpenzimeve me afro 5.4 miliardë lekë. Janë shpenzimet korente ato që parashikohet të pësojnë rritjen më të madhe, me afro katër miliardë lekë, për të mbështetur rritjen e shpenzimeve për importin e energjisë elektrike. Megjithatë, sipas këtij plani nuk krijohet rrezik për inflacionin, sepse deficiti buxhetor është rritur në një shumë relativisht të vogël.

### IV. Zhvillimet në inflacion dhe politika monetare e Bankës së Shqipërisë.

Gjithë tremujori i parë i vitit 2001 u karakterizua nga rritje e presioneve inflacioniste, të cilat u theksuan më tepër në tremujorin e dytë dhe në dy muajt në vazhdim. Ndërsa faktorët që ishin përgjegjës për rritjen e presioneve inflacioniste fillimisht kishin natyrën e *shock*-ut, zgjatja e efektit të tyre i ktheu ata në faktorë të qëndrueshëm. Tashmë, tendenca rritëse e inflacionit në Shqipëri mund të quhet e konfirmuar. Zhvillimet inflacioniste kanë kushtëzuar edhe reagimet e politikës monetare.


**Tensionet në Maqedoni**, në këtë periudhë, precipituan në trajtat e një konflikti të armatosur duke kufizuar shkëmbimet tregtare me këtë vend. Importet e mallrave nga Maqedonia, ndër të cilat importet e mallrave ushqimore zënë një peshë të konsiderueshme, u ulën gjatë kësaj periudhe. Mungesa e këtyre mallrave në treg solli shmangien e çmimeve të tyre nga vlerat historike të tyre, duke përbërë një faktor bazë në rritjen e inflacionit.

Tabela 22: Ndryshimi vjetor i IÇK-së dhe i përbërësve (në përqindje).

	Dhjetor	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht
IÇK	4.2	3.0	2.5	4.0	5.6	4.1
Ushqim, pije duhan	2.2	3.7	3.0	5.1	7.6	5.2
- Fruta, perime	12.5	13.9	8.9	18.6	29.9	21.6
Veshje dhe këpucë	-4.8	-4.9	-5.2	-5.3	5.1	-5.4
Energji, lëndë djegëse, ujë, qira	22.6	4.4	4.4	4.5	4.0	5.1
Pajisje shtëpiake	-5.1	-2.7	-1.9	-2.0	-1.9	-2.0
Kujdesi shëndetësor	8.2	5.5	5.3	5.1	5.6	5.6
Transport	4.6	2.3	1.1	1.1	2.1	1.7

**Kriza energjitike**, megjithë zbutjen e saj në këtë periudhë si pasojë e veprimit të faktorëve sezonalë, të cilët ndikojnë në reduktimin e konsumit të energjisë, ushtroi presion për rritjen e inflacionit.

Grafiku 7: Ecuria e inflacionit vjetor të disa përbërësve të IÇK.



Grupi i mallrave “Qira, ujë, lëndë djegëse, energji” ka qenë një burim konstant




inflacioni gjatë gjithë tremujorit të dytë dhe periudhës pasuese.

**Fushata elektorale** dhe zgjedhjet e përgjithshme politike të qershorit ndikuan, ashtu siç pritej, nga tradita e ngjarjeve të tilla, në rritjen e shpenzimeve buxhetore dhe të elementeve spekulative. Rezultantja e pritur e këtyre faktorëve ishte rritja e inflacionit, rritje e cila u verifikua në muajin qershor dhe vazhdoi edhe në muajin korrik. Muaji gusht shënoi një ndryshim tendence dhe inflacioni filloi të ulet, por ai mbeti prapë mbi objektivin e Bankës së Shqipërisë.

E ndodhur para zhvillimeve të tilla, Banka e Shqipërisë reagoi në dy faza. Në muajin maj, Banka e Shqipërisë ndryshoi politikën e saj ndaj të normave të interesit, duke kaluar nga një politikë lehtësuese në një politikë neutrale. Qëndrimi neutral ndaj normave të interesit nënkuptonte që Banka e Shqipërisë e shikonte nivelin e tyre si të përshtatshëm për gjendjen ekonomike të vendit, dhe politika e saj do të orientohej drejt ruajtjes së këtij niveli. Përcjellja e këtij mesazhi në ekonomi u bë nëpërmjet ndryshimit të tipit të ankandit të marrëveshjeve të riblerjes, nga ankand me shuma fikse në ankand me normë fikse dhe shumë të papërcaktuar.

Në periudhën e marrjes së këtij vendimi, vlera e inflacionit në muajt mars - prill ishte brenda objektivit të Bankës së Shqipërisë. Vendimi për të kaluar në një politikë neutrale ndaj normave të interesit ishte një masë kujdesi dhe një paralajmërim i shqetësimit të Bankës së Shqipërisë për drejtimin e ngjarjeve të ardhshme. Megjithë këtë masë parandaluese të Bankës së Shqipërisë, inflacioni vazhdoi të rritet në muajt qershor dhe korrik, dhe mbeti ende në nivele të larta në muajin gusht. Në muajt qershor – korrik, analiza e shkaqeve të inflacionit tregoi se faktorët *shock* që kanë vepruar në anën e ofertës dhe rritja e çmimeve bujqësore si pasojë e krizës në Maqedoni, po fillojnë të inkuadrohen në strukturën e kostos së ekonomisë shqiptare. Një tregues i kësaj është rritja e vazhdueshme e inflacionit bazë dhe inflacionit duke përjashtuar grupin “Fruta, perime”. Këto matje alternative të inflacionit japin një pasqyrë më të qartë të zhvillimeve inflacioniste duke ndihmuar në procesin e vendimmarrjes.


Grafiku 8: Ecuria e inflacionit sipas disa matjeve të tij.



Siç shihet, nga grafiku më sipër edhe matjet e tjera të inflacionit në Shqipëri tregojnë se ai është në rritje. Rritja e vazhdueshme e inflacionit bazë gjatë vitit në vazhdim tregon se edhe niveli i kërkesës agregate përbën një burim konstant inflacioni, duke iu bashkëngjitur faktorëve *shock* që veprojnë në anën e ofertës.

Pritjet inflacioniste në ekonomi ishin një tjetër faktor që ndikuan në ndryshimin e politikës monetare. *Yield*-et në rritje të bonove të thesarit, veçanërisht të bonove me afat maturimi më të gjatë, tregojnë se inflacioni në ekonomi pritet të jetë në nivele paksa të larta. Një rol të veçantë në formimin e pritjeve dhe të parashikimeve për vlerat e ardhshme të inflacionit, ka situata fiskale dhe energjitike. Vazhdimi i problemeve në sigurimin e energjisë elektrike, parashikimi i një financimi në rritje të deficitit buxhetor në pjesën tjetër të vitit, rritja e çmimeve të energjisë elektrike, rritja e mundshme e çmimeve të naftës, efektet e rritjes së pagave si dhe vazhdimi i gjendjes së rënduar politike dhe financiare në rajon përbëjnë burim shqetësimi për Bankën e Shqipërisë, në drejtim të përmbushjes së objektivit kryesor të saj, ruajtjes së stabilitetit të çmimeve.

Grafiku 9: *Yield*-i i bonove të thesarit në tregun primar.




Normalisht, vlerat e ulëta të inflacionit bazë në Shqipëri, nuk do të ofronin shkak për ndërhyrje nga ana e Bankës së Shqipërisë. Megjithatë, të para brenda kontekstit të ngjarjeve aktuale dhe zhvillimeve të ardhshme të tyre, prirja e qëndrueshme rritëse e inflacionit e përshkruar nga të dyja këto matje nuk duhet nënvlerësuar. Të gjithë këta faktorë bënë që Banka e Shqipërisë të ndërhyjë duke rritur normat e interesit, në funksion të përmbushjes së objektivit të shpallur të saj për ruajtjen e inflacionit vjetor në kufijtë 2 – 4 për qind. Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me vendimin nr. 72, datë 15.08.2001 rriti me 0.5 pikë përqindjeje normën e interesit të zbatuar në ankandet e repove, nga 6.5 për qind në 7 për qind.

Zhvillimet në çmimet e konsumit kërkojnë një ndjekje mjaft të kujdesshme nga Banka e Shqipërisë për të mundësuar reagimin në kohë dhe efikas. Me qëllim që vendimet e Bankës së Shqipërisë të jenë sa më realiste dhe të dobishme, ato do të mbështeten jo vetëm në inflacionin e publikuar nga INSTAT por edhe në inflacionin bazë, që llogaritet nga vetë Banka e Shqipërisë. Përveç këtyre dy

kategorive rëndësi merr edhe bazimi në inflacionin e rezultuar në bazë të shportës së re. Siç dihet, INSTAT ka realizuar vrojtimin e nivelit të jetesës në bazë të të cilit përcaktohet shporta e mallrave që përfaqësojnë konsumin në vend. Rezultatet paraprake japin ndryshime të pritshme të shportës ku në masë të konsiderueshme është reduktuar pesha e grupit “ushqim, pije, duhan”. Si pasojë e ndryshimeve të peshave të grupmallrave në shportë, indeksi i çmimeve të konsumit, gjithashtu, është i ndryshëm. Megjithatë, qëndrimin përfundimtar zyrtar Banka e Shqipërisë do ta deklarojë pasi të jetë publikuar inflacioni në bazë të shportës së re


Faktorët e listuar më lart kanë të bëjnë, në pjesën më të madhe, me vlerësime cilësore të ndikimit të tyre në treguesin e inflacionit. Ndërkohë, Banka e Shqipërisë evidenton në mënyrë empirike, si një faktor që ndikon ndjeshëm në vlerat e inflacionit, **kursin e këmbimit** të lekut me monedhën amerikane dhe me atë europiane.

Grafiku 10: Ecuria e IÇK dhe REER.



Ndërkohë, zhvillimet në kursin e këmbimit përgjatë tremujorit të dytë të vitit 2001, treguan se pas mbiçmimit në tremujorin e parë të këtij viti, dollari amerikan pësoi një nënçmim gjatë tremujorit të dytë. Kështu, raporti mesatar i kursit nominal të këmbimit euro/dollar ishte 0.938. Ndërsa në tremujorin e dytë ishte 0.873 ose një nënçmim prej afro 7 për qind. Krahasuar me tremujorin e dytë të vitit të kaluar ky kurs, pati një nënçmim prej 17 për qind. Në fund të muajit korrik, ky raport pati një rritje të lehtë me afro 0.861 në krahasim me muajin qershor. Vihet re se ky nivel është më poshtë se mesatarja e tremujorit të dytë të këtij viti. Kjo tendencë në rritje e raportit euro/dollar vërehet se ruhet edhe gjatë muajit gusht.

Grafiku 11: Kursi nominal i këmbimit euro/dollar.



Zhvillimet në tregun e brendshëm valutor duhet thënë se kanë vazhduar të ndjekin dhe kanë pasqyruar zhvillimet në raportet mes monedhës amerikane dhe asaj europiane. Në tremujorin e dytë të vitit 2001 leku u nënçmua kundrejt dollarit amerikan me 2.72 pikë për qind dhe mbiçmua kundrejt euros me 2.8 pikë për qind. Në muajin qershor janë vërejtur përkatësisht vlerat më të larta dhe më të ulëta të këmbimit të lekut me dollarin amerikan dhe euron për gjithë vitin. Tashmë, në tregun shqiptar është konfirmuar një sjellje simetrike e kundërt e lekut kundrejt dy monedhave kryesore, dollarit amerikan dhe euros.

Grafiku 12: Ecuria e kursit mujor të këmbimit.




Tabela 23: Ecuria e kursit mesatar të këmbimit të lekut.

Kursi i lekut	Tremujori I	Tremujori II	Muaji qershor
Lek / USD	142.97	146.86	148.56
Lek / Euro	132.04	128.32	126.82

## **V. Zhvillimet në sektorin e jashtëm të ekonomisë**

Tremujori i dytë i vitit 2001, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, shënoi një rritje prej 10.3 për qind të totalit të transaksioneve korente duke kapur shumën e rreth 790 milionë dollarëve amerikanë. Të ardhurat e llogarisë korente për këtë tremujor, vlerësohen rreth 348 milionë usd ose 6.6 për qind më të larta, se ato të së njëjtës periudhë për vitin e kaluar. Po kështu edhe të dalat kapën shifrën e 444 milionë dollarëve amerikanë, duke rezultuar 13.3 për qind më të larta se ato të vitit të kaluar.

### **V.1. Bilanci tregtar.**

Bilanci tregtar vazhdon të mbajë peshën kryesore ndër faktorët që përcaktojnë ecurinë e bilancit të llogarisë korente duke përfshirë më tepër se gjysmën e totalit të transaksioneve të këtij bilanci. Deficiti i bilancit tregtar, gjatë tremujorit të dytë, kapi shifrën 233.5 milionë dollarë duke qenë kështu 23.6 për qind më i lartë se deficiti tregtar i tremujorit të dytë të vitit paraardhës. Në krahasim me të njëjtën periudhë, eksportet u rritën me 28 për qind (duke arritur shifrën 88 milionë dollarë) ndërsa importet u rritën me rreth 25 për qind (duke arritur nivelin 321 milionë dollarë). Eksportet janë rritur si pasojë e rritjes së eksporteve nga përpunimi aktiv, të cilat zënë rreth 70 për qind të totalit. Rritja e importeve ka ardhur kryesisht si pasojë e rritjes së importeve të grupmallrave makineri dhe pajisje, metale bazë dhe importe nga përpunimi aktiv.

Edhe gjatë këtij tremujori tregtia ka qenë e orientuar drejt vendeve të Bashkimit Europian me të cilat Shqipëria ka kryer rreth 82 për qind të të gjitha transaksioneve të bilancit të pagesave. Tregtia me këto vende ka pësuar një rritje prej 24 për qind në krahasim me tremujorin korrespondues të një viti më parë. Shtetet kryesore me të cilat Shqipëria kryen marrëdhënie tregtare rezultojnë Italia (52 për qind të volumit të tregtisë) dhe Greqia (19 për qind).

### **V. 2. Shërbimet.**

Edhe gjatë këtij tremujori bilanci i shërbimeve rezultoi pozitiv pavarësisht se diferenca midis shërbimeve të importuara dhe atyre të eksportuara ishte mjaft më e ngushtë nga ajo e tremujorit paraardhës (1.47 milionë dollarë kundrejt 16.2 milionë dollarëve). Eksporti i shërbimeve megjithëse është më i ulët nga ai i tremujorit paraardhës, është 21.4 për qind më i lartë nga eksporti i shërbimeve të tremujorit të dytë të vitit 2000. Totali i shërbimeve të eksportuara kap shifrën 108 milionë dollarë prej të cilave 92 milionë dollarë (rreth 85 për qind) kanë ardhur nga turizmi. Në krahasim me tremujorin korrespondues të vitit paraardhës, të ardhurat nga turizmi kanë shënuar një rritje prej 22 për qind. Vlera totale e shërbimeve të importuara është pothuajse në të njëjtin nivel me vlerën e shërbimeve të eksportuara (107 milionë usd) duke qenë 16.3 për qind më e lartë nga vlera e shërbimeve të importuara gjatë tremujorit të dytë të vitit 2000. Gjatë importit të shërbimeve shpenzimet shkojnë jo vetëm për turizëm, por edhe për

transport. Shpenzimet për transportin nuk kanë pësuar ndonjë ndryshim të dukshëm në krahasim me shpenzimet e vitit të kaluar.

### **V. 3. Të ardhurat.**

Bilanci i të ardhurave gjatë këtij tremujori ka rezultuar pozitiv në nivelin 36 milionë usd ose 16 për qind më i lartë nga bilanci i tremujorit të dytë të vitit të kaluar. Të ardhurat nga puna kanë pësuar një rënie prej 14 për qind në krahasim me të ardhurat gjatë tremujorit të dytë të vitit 2000. Të ardhurat nga interesat mbi rezervat jashtë vendit qëndrojnë në nivelin 19.6 milionë usd. Ato kanë pësuar rritje si në krahasim me tremujorin korrespondues të një viti më parë (81 për qind), ashtu edhe me tremujorin e parë të këtij viti (32.6 për qind). Duket se shumatat e investuara jashtë vendit vazhdojnë të shtohen duke rritur në këtë mënyrë të ardhurat nga interesat, pavarësisht se normat e interesit vazhdojnë të mbeten në nivele të ulëta.

#### **V. 4. Transfertat.**

Bilanci i transfertave korente për këtë tremujor kapi shifrën pozitive prej 96.4 milionë usd, e cila është 1.4 milionë usd më e lartë nga e njëjta shifër për tremujorin e dytë të vitit 2000. Zëri kryesor në këtë kategori vazhdon të mbetet “dërgesa nga emigrantët” me 104.6 milionë usd, i cili, megjithatë, është ulur me 14.1 për qind në krahasim me tremujorin e dytë të vitit paraardhës. Ky tremujor regjistroi nivelin më të ulët të prurjeve nga emigrantët që nga tremujori i parë i vitit 2000, kur ky zë rezultoi në shifrën e ulët prej 66 milionë usd.

#### **V. 5. Përmbyllëse.**


Deficiti i llogarisë korente, nga fundi i qershorit të vitit 2000 deri në fund të qershorit të vitit 2001, u rrit me 30.5 milionë usd duke arritur nivelin 96 milionë usd. Ky deficit është financuar prej flukseve hyrëse të kapitaleve, bilanci pozitiv i të cilave, në fund të periudhës, vlerësohet me rreth 82 milionë usd ose 102 për qind të të njëjtës shifër të tremujorit të dytë të vitit 2000. Kjo shifër përbëhet nga 28 milionë usd të transfertave kapitale dhe 54 milionë usd të bilancit pozitiv të llogarisë financiare. Detyrimet financiare kundrejt jorezidentëve kapën shifrën e 49 milionë usd, e cila është pothuajse e barabartë me të njëjtën shifër të një viti më parë, por në mënyrë të konsiderueshme më e ulët se e njëjta shifër për tremujorin e kaluar. Kjo rënie në detyrimet financiare ka ardhur kryesisht si pasojë e rënies në investimet e huaja direkte me 16.7 milionë usd.

Flukset hyrëse në mjete valutore në formën e kapitaleve financiare (kryesisht disbursimet e kredive të huaja dhe investimet e huaja nga procesi i privatizimit të ndërmarrjeve shtetërore) dhe transfertave korente në *cash* u reflektuan në rritjen e rezervave valutore të autoritetit monetar me 15.3 milionë usd. Kjo rritje është regjistruar kryesisht në mjetet valutore.

#### **VI. Zhvillimet monetare**

Tendencat inflacioniste në rritje të ekonomisë gjatë tremujorit të dytë u reflektuan edhe në treguesit monetarë. Norma vjetore e rritjes së ofertës monetare kaloi nga 14.4 për qind në fillim të tremujorit, në 15.7 për qind në fund të tij. Ndonëse trajektorja e rritjes së M3 është disi e shtrembëruar nga rritja madhe e parasë jashtë bankave në muajin qershor, normat e rritjes së M3 kanë ardhur duke u rritur gjatë këtij tremujori. Ato kanë manifestuar nivele më të larta se sa historiku i tyre dhe kanë qëndruar mbi objektivin e vendosur në programin monetar të Bankës së Shqipërisë.

Grafiku 13: Norma vjetore e rritjes së M3 dhe objekti i Bankës së Shqipërisë.



Shënim: Objekti për M3 është vjetor. Kjo do të thotë që realizimi ose jo i këtij objekti matet në fund të çdo viti.


Një veçori tjetër e zhvillimeve monetare të kësaj periudhe, e cila flet për rritjen e inflacionit në ekonomi është ulja e maturitetit mesatar të M3. Komponenti më likuid i ofertës monetare, agregati M1, është rritur në të tre muajt. Raporti i tij ndaj ofertës monetare u rrit nga 34.5 për qind, në fillim të tremujorit, në 35.9 për qind në fund të tij.

Edhe treguesit monetarë, ashtu si ata të ekonomisë reale, janë ndikuar nga ngjarjet e kësaj periudhe, veçanërisht të zgjedhjeve të përgjithshme parlamentare të qershorit dhe ngjarjeve të zhvilluara në sfondin e tyre. Shpenzimet e larta buxhetore në muajin qershor sollën rritjen e parasë në qarkullim në këtë muaj, ndërsa depozitat në valutë shënuan ulje. Mbulimi me kredi i sektorit privat të ekonomisë nuk ishte në vlerat e vërejtura në muajt paraardhës, ndërsa financimi i deficitit buxhetor nga sistemi bankar u rrit.

Rritja e mjeteve valutore të sistemit bankar vazhdon të mbetet burimi kryesor i rritjes së ofertës monetare, megjithatë, në terma relativë, roli i tyre është në ulje. Ndërsa në tremujorin e parë rritja e mjeteve valutore neto të sistemit bankar shqiptar përbënte 160 për qind të rritjes së ofertës monetare, në tremujorin e dytë kjo shifër ka zbritur në vetëm 6 për qind të saj. Në tremujorin e dytë, përbërësi kryesor i kërkesës për mjete monetare është kërkesa e ekonomisë për mjete të brendshme, në formën e kredisë për ekonominë dhe të kredisë për qeverinë.



Grafiku 14: Ecuria relative e përbërësve të kërkesës për para.



Arsyeja kryesore e ndryshimit të ritmit të rritjes së mjeteve valutore neto është ulja e depozitave në valutë gjatë tremujorit të dytë, ulje e cila ka sjellë dhe pakësimin e mjeteve valutore neto të bankave tregtare me 1.87 miliardë lekë. Gjatë tremujorit të parë, depozitat në valutë në bankat tregtare u rritën me 8.9 miliardë lekë, duke ndikuar në rritjen e mjeteve valutore neto të tyre me 7.8 miliardë lekë, ndërsa, në tremujorin e dytë, niveli i depozitave në valutë u pakësua me 0.1 miliardë lekë.

Mjetet valutore neto të Bankës së Shqipërisë, për të njëjtën periudhë, janë rritur me 2.4 miliardë lekë. Gjatë tremujorit të dytë, rezerva ndërkombëtare neto e Bankës së Shqipërisë, e cila është dhe një ndër tre objektivat sasiorë të Bankës së Shqipërisë, është rritur me 22.9 milionë usd. Në fund të muajit qershor, kjo rezervë ishte 493.3 milionë usd ose 17.4 milionë usd mbi objektivin e vendosur për të.

Kredia e sistemit bankar për qeverinë edhe në tremujorin e dytë vazhdoi të jetë e ulët dhe larg niveleve të parashikuara në programin monetar. Deficiti buxhetor, në fund të muajit qershor, arriti në 13.8<sup>21</sup> miliardë lekë. Burimet kryesore të mbulimit të këtij deficiti kanë qenë të ardhurat e privatizimit, në masën 9 miliardë lekë dhe financimi i huaj, në masën 4.5 miliardë lekë. Për pasojë, qeveria nuk ka qenë e detyruar të shesë bono thesari për mbulimin e deficitit të buxhetit të saj. Emetimi i bonove të thesarit ka qenë kryesisht në funksion të mbulimit të maturimit të bonove ekzistuese të thesarit. Huamarrja e re e qeverisë nëpërmjet emetimit të bonove të thesarit, duke u nisur nga fillimi i vitit, është vetëm 0.44 miliardë lekë.

Gjendja e pretendimeve neto të sistemit bankar ndaj qeverisë është ulur me 4.5

<sup>21</sup> Vlera e deficitit buxhetor është nxjerrë nga evidencat kontabile të raportuara nga bankat tregtare për shpenzimet e qeverisë. Ajo nuk përputhet me deficitin buxhetor të evidentuar në seksionin e zhvillimeve fiskale, për shkak të momenteve të ndryshme të regjistrimit të veprimeve.

miliardë lekë në tremujorin e dytë. Në prani të një kërkesë të ulët të qeverisë për fonde, Banka e Shqipërisë ka ruajtur një pozicion të tërhequr në ankandet primare të bonove të thesarit, duke iu lënë më shumë hapësirë bankave tregtare në investimin e fondeve të tyre. Pretendimet neto ndaj qeverisë, të Bankës së Shqipërisë janë ulur me 4.9 miliardë lekë ndërsa pretendimet neto të bankave tregtare janë rritur me 0.4 miliardë lekë.

Në muajin qershor, Banka e Shqipërisë ka kryer shitjen me të drejta të plota të bonove të thesarit me vlerë 4 miliardë lekë nga portofoli i saj. Kjo ka ndikuar në shpërndarjen e tepricës së pretendimeve ndaj qeverisë midis Bankës së Shqipërisë dhe bankave tregtare, duke ulur pretendimet e Bankës së Shqipërisë dhe duke rritur pretendimet e bankave tregtare për shumën në fjalë.


Parashikimet për fundin e vitit janë për një rritje të huamarrjes së qeverisë nga sistemi bankar, duke qëndruar gjithësesi brenda kufijve të programit monetar të Bankës së Shqipërisë.

## VI. 1. Kredia për ekonominë.

Aktiviteti kreditues ka shënuar rritje gjatë tremujorit të dytë. Teprica e kredisë për ekonominë, gjatë këtij tremujori, është rritur me 2.11 miliardë lekë, ndërsa rritja e kësaj teprice në tremujorin e parë ishte vetëm 0.6 miliardë lekë. Veçanërisht, muajt prill-maj, janë muajt me rritjen më të madhe në masë absolute të tepricës së kredisë.

Kredia e re e lëvruar, gjatë këtij tremujori, 8.2 miliardë lekë, ka qenë 74 për qind më e lartë se në tremujorin e parë. Veçanërisht, akordimi i kredisë ka qenë i lartë në muajin qershor, 3.6 miliardë lekë, duke përbërë 44 për qind të kredive të reja të akorduara si tremujor. Në grafikun e mëposhtëm, paraqitet ecuria e kredisë së re të akorduar gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit.

Grafiku 15: Akordimi i kredisë së re sipas muajve.



Përqindja e kredive në lekë ndaj totalit të kredive, gjatë tremujorit të dytë është ulur më tej me 0.9 pikë përqindjeje duke zbritur në 35.1 për qind. Kjo është rrjedhojë e faktit se kredia e re vazhdon të jepet, në masën më të madhe, në valutë. Megjithëse gjatë muajit qershor, kreditimi në lekë ka arritur vlerën më të lartë absolute, rreth 1 miliardë lekë, raporti i kredisë së re të akorduar në lekë përbënte vetëm 27.8 për qind të kredive të reja të akorduara.

Normat e larta të interesit të kredive në lekë kundrejt atyre në valutë sjellin një preferencë për këto të fundit. Në muajin korrik, kjo diferencë luhetet në intervalin 3–5 pikë përqindjeje, në varësi të bankave dhe të afateve të ndryshme të maturimit.

Në këtë preferencë për marrjen e kredisë në valutë, përveç përparësisë që ofrojnë normat e ulëta të interesit, ndikon edhe mosperceptimi i rrezikut të kursit të këmbimit. Në këtë drejtim, një rol të rëndësishëm ka patur stabiliteti i kursit të këmbimit të lekut. Gjithashtu, fakti që një pjesë e madhe e transaksioneve në ekonominë shqiptare (dhe e të ardhurave të bizneseve që marrin kredi) është në valutë ndihmon në uljen e rrezikut të kursit të këmbimit.

Mungesa e këtij rreziku bën që preferenca për marrjen e kredisë në valutë të vazhdojë, për sa kohë normat e interesit të zbatuara për kreditë në lekë të mos iu afrohen atyre të kredidhënies në valutë.

Sipas të dhënave të muajit qershor, diferenca midis interesit mesatar të ponderuar për kreditë e akorduara dhe depozitave të pranuar në lekë ishte 7.25 pikë përqindjeje, duke qëndruar 1-2 pikë përqindjeje më lart se kjo diferencë për pranimet e depozitave dhe kreditë e reja në dollarë. Diferenca në normën e interesit të pranimeve të reja të depozitave dhe të kredive të reja, në lekë dhe në valutë, duhet të reflektojë diferencat në inflacionet e pritshme përkatëse. Nisur nga kjo konsideratë, një shpjegim i mundshëm për diferencën midis (1-2 pikë përqindjeje) normave të interesit të kredive dhe depozitave në lekë dhe në valutë, është besimi i ulët i institucioneve financiare në qëndrueshmërinë e vlerës, së brendshme ose të jashtme të lekut.


Kredia e re e akorduar vazhdon të jetë e orientuar drejt maturiteteve afatshkurtra. Gjatë gjashtëmujorit të parë, kredia e re e akorduar është 12.5 miliardë lekë nga e cila 63 për qind është kredi afatshkurtër, 28 për qind afatmesme dhe vetëm 9 për qind është kredi afatgjatë.

## **VI. 2. Oferta monetare.**

Oferta monetare u rrit me 9 miliardë lekë gjatë tremujorit të dytë, afër vlerës 9.9 miliardë lekë të rritjes së saj gjatë tremujorit të parë. Në masë absolute, oferta monetare në fund të tremujorit ishte 347 miliardë lekë. Rritja vjetore e M3, në fund të tremujorit të dytë, kaloi në 15.7 për qind, nga 14.4 për qind që ishte në fillim të tremujorit.

Rritja e M3, në masën më të madhe mori formën e parasë jashtë bankave. Gjatë tremujorit të dytë paraja jashtë bankave u rrit me 6.4 miliardë lekë dhe raporti i saj ndaj M3 u rrit në 29.2 për qind nga 28 për qind që ishte në fillim të tij. Rritja më e madhe e parasë jashtë bankave ishte në muajin qershor, afërsisht 2.8 miliardë lekë. Në terma relativë, paraja jashtë bankave është përbërësi i M3 me rritjen më të madhë vjetore, 18.2 për qind.

Grafiku 16: Oferta monetare dhe përbërësit e saj.



Edhe depozitat në lekë kanë patur rritje gjatë tremujorit të dytë. Rritja e tyre, gjatë tremujorit të dytë, është 2.8 miliardë lekë dhe në fund të tij ato ishin 173.4 miliardë lekë. Rritja e depozitave në lekë është e pranishme si në depozitat me afat ashtu edhe në ato pa afat. Megjithatë, ashtu si dhe për ofertën monetare në tërësi, edhe brenda depozitave në lekë mund të vërehet një zhvendosje drejt afateve më të shkurtra të maturimit. Kështu, depozitat pa afat janë rritur me 1.7 miliardë lekë ndërsa depozitat me afat janë rritur me 1.1 miliardë lekë. Rritja vjetore e depozitave në lekë, 10.3 për qind, është më e ulëta ndër të tre komponentët e M3.

Rritja e depozitave në lekë dhe kërkesa e ulët e qeverisë për fonde kanë kontribuar në rritjen e rezervave të tepërta të bankave tregtare. Në këto kushte, Banka e Shqipërisë ka tërhequr vazhdimisht një pjesë të rezervave të tepërta duke rritur portofolin e saj të repove.

Një veçori e tremujorit të dytë është se bankat filluan të shfrytëzojnë edhe instrumentet e tjera të vëna në dispozicion nga Banka e Shqipërisë, depozitat njëditore. Ato kanë rritur zhvendosjet e fondeve midis depozitave njëditore dhe repo-ve, në funksion të nevojave dhe të parashikimeve të tyre për gjendjen e likuiditetit.

Depozitat në valutë janë ulur me 0.14 miliardë lekë, në ndryshim nga tremujori i parë kur ato patën një rritje prej 8.93 miliardë lekësh. Kjo rënie është e pranishme në muajt prill dhe qershor dhe kryesisht në depozitat pa afat. Duke patur parasysh rritjen e depozitave pa afat në lekë, rënia e depozitave pa afat në valutë mund të interpretohet si zhvendosje e mjeteve të qarkullimit në lekë, në përgjigje të shpenzimeve të rritura qeveritare të kësaj periudhe. Pesha e

depozitave në valutë ndaj M3 zbriti në 20.9 për qind në fund të tremujorit nga 21.5 për qind që ishte në fillim të tij, ndërsa norma vjetore e rritjes së depozitave në valutë është 20.3 për qind.

## VII. Tregjet financiare dhe normat e interesit.

Në ndryshim nga tremujori i parë, në tremujorin e dytë, politika e Bankës së Shqipërisë ndaj normave të interesit ka qenë përgjithësisht një politikë neutrale. Reagimi i sistemit bankar u shfaq në rritjen e *yield*-it të bonove të thesarit për të tre maturitetet si dhe në rritjen e interesit për depozitat në lekë me afat tremujor.

Tregu i letrave me vlerë, vazhdon të identifikohet me tregun primar të bonove të thesarit, treg ku Banka e Kursimeve është aktori dominant, duke luajtur në njëfarë mënyre rolin e arbitrit në përcaktimin e normave të interesit. Dominimi i tregut të bonove të thesarit nga kjo bankë do të vazhdojë për sa kohë ajo të zotërojë pjesën më të madhe të likuiditetit të tepërt në sistem. Ndërkohë, pjesëmarrja e institucioneve financiare jobankare dhe e individëve mbeti përsëri e vogël, larg asaj që pritej.

Tabela 24: *Yield*-i mesatar i ponderuar për bonot e thesarit (në %).

Muajt	3-mujore	6-mujore	12-mujore
Prill	7.58	9.45	10.22
Maj	7.47	9.17	9.68
Qershor	7.48	9.23	9.91
Korrik	7.49	9.24	9.95
Gusht	7.74	9.38	10.14

Në tremujorin e dytë, bankat tregtare shfrytëzuan instrumentet lehtësuese të ofruara nga Banka e Shqipërisë si depozitat dhe kreditë njëditore. Bankat tregtare e kanë gjetur me interes instrumentin e depozitave njëditore në administrimin e problemeve afatshkurtra të likuiditetit. Ato investojnë vazhdimisht një pjesë të rezervave të tepërta të tyre në depozita njëditore.

Tabela 25: Investimet në depozitë njëditore sipas muajve (në miliardë lekë).

	Totali kumulativ i investuar
Prill	29,5
Maj	29,1
Qershor	27,4
Shuma	86,2

Interesi i depozitave njëditore aktualisht është 4.5 për qind<sup>22</sup>. Norma e interesit për këto depozita shërben si dysHEME për normat afatshkurtra të tregut të parasë. Kjo vihet re në tregun ndërbankar, ku interesi në marrëveshjet njëditore

<sup>22</sup> Ky interes qëndron 2.5 pikë përqindjeje poshtë interesit të ankandit të repove.

ndërbankare është 4.5 për qind ose vetëm 0.5 pikë për qind më i lartë se sa ai i depozitave njëditore.

Kuadri i ri i instrumenteve të politikës monetare ka bërë që të zbuten luhatjet e normave të interesit në tregun ndërbankar. Në tremujorin e dytë, normat e interesit në këtë treg janë luhatur në kufijtë 4.25 për qind - 7.25 për qind, duke patur si referencë nivelin e interesave në instrumentet e tregut dhe lehtësirat e ofruara nga Banka e Shqipërisë.

Kredia njëditore nga bankat është përdorur më rrallë. Totali i kredisë njëditore për periudhën deri në fund të korrikut është 4 miliardë lekë dhe është përdorur nga 6 banka. Interesi i ofruar nga kjo kredi është 9 për qind<sup>23</sup>. Rreth 79 për qind, e ka përfituar Banka e Kursimeve. Mungesat për likuiditet në sistem kanë qenë të vogla dhe në rastet kur ka qenë evidente, forma më e shpejtë për mbulimin e nevojave për likuiditet të bankave ka qenë përdorimi në masën 5 për qind i rezervës së detyrueshme.

Kredia lombard, nuk është zbatuar asnjëherë gjatë kësaj periudhe. Kjo i detyrohet stabilizimit të treguesve makroekonomikë dhe financiarë, gjendjes së mirë të likuiditetit në sistemin bankar dhe investimit të burimeve, kryesisht, në periudha me maturitete të shkurtra dhe me rrezik të ulët.

Tregut të kapitaleve, si një mundësi tjetër e investimit dhe e sigurimit të burimeve të financimit të bizneseve, i munguan zhvillimet e reja. Në muajin qershor u vërejt një pakësim i rezervave të tepërta në sistem si pasojë e tërheqjes së likuiditetit nga ana e Bankës së Shqipërisë nëpërmjet shitjes, me të drejta të plota, të një bonoje thesari me vlerë 4 miliardë lekë. Këto rezerva të tepërta, duke mbetur në nivele të ulëta dhe në muajt në vazhdim kanë sjellë rritjen e normës së interesit të tregut primar të bonove të thesarit. *Yield*-i i zbatuar në ankandet e marrëveshjeve të riblerjes, pas muajit prill, ka qenë i fiksuar në 6.5 për qind gjatë gjithë tremujorit të dytë.

Tabela 26: Interesi mesatar i ponderuar për depozitat në lekë (në %).

Muajt	3-mujore	6-mujore	12-mujore	Totali depozitave
Prill	6.84	7.45	7.69	7.09
Maj	6.93	7.44	7.74	7.12
Qershor	6.92	7.27	7.68	7.11

Të dhënat e interesit të pranimeve të reja të depozitave, tregojnë se niveli i tyre është lëkundur në diapazone të ngushta, me një rritje të vogël të normave të interesit të depozitave tremujore. Përrjashtim përbëjnë depozitat gjashtëmujore, interesi i të cilave ka një prirje të qartë rënëse. Depozitat me maturim gjashtëmujor janë tipi më pak i frekuentuar i depozitave, nga të tre maturitetet. Si pasojë, normat e interesit të tyre janë më të luhatshme dhe ndikimi i politikës monetare në nivelin e tyre është i pjesshëm.

<sup>23</sup> Interesi i kredive njëditore është 2.5 pikë përqindjeje më i lartë se interesi i ankandëve të marrëveshjeve të riblerjes.

Ngushtimi i diferencës së normave të interesit për bonot e thesarit dhe për depozitat me afat në lekë është i pranishëm për të tre maturimet. Por, ky ngushtim është më i theksuar në muajin prill dhe maj si dhe për maturimet gjashtë dhe dymbëdhjetëmuajore, ndërsa për muajin qershor intervali ka një tendencë të lehtë rritëse.

Ndërkohë, normat mesatare të interesit për kreditë e reja të akorduara në lekë vazhdojnë të jenë më të ngurta dhe të shfaqin lëvizje të çrregullta në secilin maturim. Norma mesatare e rezultuar në fund të muajit qershor, 14.36 për qind, është më e ulët se ajo e fillimit të tremujorit.

Tabela 25: Interesi mesatar i kredive të dhëna gjatë periudhës mars-korrik 2001.

	Mbi 3 vjet	1-3 vjet	6-12 muaj	Deri 6 muaj	Sistemi
Mars	15.58	22.19	16.10	23.22	17.62
Prill	13.51	15.50	22.27	15.08	15.91
Maj	15.17	18.03	19.38	23.69	18.18
Qershor	15.22	14.58	13.98	24.00	14.36
Korrik	13.30	17.91	15.70	23.46	16.89

Kjo tregon se kreditimi nga sistemi bankar ende nuk po shërben si një kanal efektiv për transmetimin e vendimeve të politikës monetare në ekonomi.